

**INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË
SË VERIUT NË VITIN 2024, DERI MË 20.02.2025**

TË DHËNA JAVORE

Në periudhën 14.02-20.02.2025 është regjistruar një rast i ri me pertusis. Bëhet fjalë për një rast nga Negotina në moshë 5 vjet, i vaksinuar sipas moshës, që nuk është shtruar në spital dhe që nuk ka e që ka lidhshmëri epidemiologjike me një të sëmurë tjetër. Me rezultat pozitiv laboratorik nga data 11.02.2025.

Të dhëna kumulative

- Në periudhën 2024/2025 deri më 20.02.2025 janë regjistruar gjithsej 1.182 raste me pertusis me incidencë 64,4/100.000 banorë.
- Numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup (70,3%) ndërkohë që raste janë regjistruar edhe në 22 qytete të tjera.
- Në RMV ka epidemi aktive në Shkup.
- Incidencë më e lartë prej 265,1/100.000 banorë është regjistruar në Kratovë, në Shkup (136,9/100.000) dhe në Kumanovë (102,5/100.000).
- Numri më i madh i të sëmurëve i përkasin grupmoshës 0-4 vjet (37%), ndërsa incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet (1.572,4/100.000).
- Nga numri i përgjithshëm i rasteve (1.182), 746 ose 63,1% nuk kanë qenë të vaksinuar, nuk i kanë marrë të gjitha dozat e vaksinës, ose nuk ka të dhëna për vaksinim.
- Nga rastet që janë plotësisht të vaksinuar, nga pranimi i dozës së fundit ka kaluar mesatarisht 13,7 vjet.
- Në spital janë shtruar 192 persona, ndërsa numri më i madh i tyre (n=168, 88%) janë nga 0- 4 vjet, e që kanë qëndruar në spital mesatarisht nga 8 ditë.
- 1.179 raste janë konfirmuar në laborator.
- Nga 18.01.2024 - 23.01.2025 janë dhënë gjithsej 96.114 doza të vaksinës e cila përmban komponentë kundër pertusis.

**Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive
ISHPRMV**

21.02.2025